

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANE

Nr. _____ Rep. 7032

Nr. _____ Kol. 3021

Marjinda E. Demollari
Tatime e Pulles
U. Paqna



KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më date 16.11.2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë) përpara meje Noteres
Dr. Vera Spahiu anëtare e Dhomës së Noterisë Tirane, u
paraqitën palët e mëposhtme:

"ERNIKU" sh.p.k, shoqeri e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me
NIPT J71925004S dhe seli ne Sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit "Karl Topia",
Kulla nr. 3, sipas Vendimit te Asamblese se dates 31.10.2017 e përfaqësuar nga
Administratori i shoqerise Iljaz Spahiu,

ne vijim referuar si "Shitesi"

Vera Spahiu, shtetase shqiptare, lindur ne Kruje me 25.06.1974 dhe banuese ne
Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,
identifikuar nga karta e identitetit me Nr. H45625092N, ne cilesine e
bashkeshortes se ortakut te vetem te Erniku Sh.p.k, Iljaz Spahiu,

ne vijim referuar si "Dhenese e Pelqimit",

"BUSHTRICA 2017" Shpk, shoqeri e regjistruar ne Qendren Kombetare te
Biznesit me numer NIPT L72112005K, dhe seli ne Qendra e Biznesit "Karl
Topia", Kulla 3, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar nga Znj. Anila Doko,

ne vijim se bashku referuar si "Pale e trete";

dhe

"DOKO" sh.p.k, shoqeri e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me
NIPT J62903324K dhe seli ne Katundi i Ri Elbasan, sipas Vendimit te Asamblese
se dates 31.10.2017 e përfaqësuar nga Administratori i shoqerise Fatbardh Doko,

ne vijim referuar si "Blerësi"

1

MEQËNËSE:

A. Shoqerite "Erniku" Sh.p.k. dhe "Doko" Sh.p.k kane te drejte koncesioni dhe gezojne te drejtat e detyrimet e koncesionit per realizimin e nje hidrocentrali (forma BOT) per tu realizuar ne Bashkine Librazhd, me nje fuqi prej 4060 kw, ne perputhje me kontraten e koncesionit e lidhur ndermjet MIE (Ministrise se Infrastruktures dhe Energjitikes) dhe shoqerise "Bushtrica 2017" Sh.p.k, Nr. Prot. 2442, Nr. Kol. 1136/2, date 27.10.2017;

B. Ne kuder te Kontrates te Koncesionit eshte krijuar shoqeria koncesionare "Bushtrica 2017" Sh.p.k. regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT L72112005K;

C. Shoqeria "Bushtrica 2017" Sh.p.k ka 2 kuota, te cilat zoterohen nga shoqerite perkatese sipas numrit te kuotave ne vijim:

- "Erniku" Sh.p.k zoteron 1 kuote te kapitalit te regjistruar te shoqerise koncesionare "Bushtrica 2017" Sh.p.k.,
- "Doko" Sh.p.k. zoteron 1 kuote te kapitalit te regjistruar te shoqerise koncesionare "Bushtrica 2017" Sh.p.k.

Duke pasur parasysh parashtrimet e mesiperme, palet bien dakord si vijon:

Neni 1

Objekti i Kontrates

- 1.1 Shitesi, si zoterues i 1 kuote te kapitalit themeltar te "Bushtrica 2017" Sh.p.k. i shet Bleresit kuoten e tij te Shoqerise Koncesionare "Bushtrica 2017" Sh.p.k, perkatesisht 49% te kapitalit.
- 1.2 Bleresi merr persiper qe t'i paguaje Erniku sh.p.k. vleren e shitjes se kuotave kundrejt transferimit te pronesise se 1 kuote te Kapitalit Themeltar ne Shoqerine "Bushtrica 2017" Sh.p.k.
- 1.3 Ne kete menyre, me kalimin e pronesisë me ane te kesaj Kontrate Shitje Kuotash te kuotave te Shoqerive Shitese, Doko Sh.p.k. do te jete ortak i vetem, me 100 % te kuotave te kapitalit



1.4 Shitja e 1 kuote te kapitalit themeltar te "Bushtrica 2017" Sh.p.k dhe blerja nga shoqeria "Doko" Sh.p.k., si me siper percaktohet, sjell humbjen e te drejtes se pronesise se Shitesit mbi kete kuote dhe transferimin me te drejta te plota tek Bleresi.

Neni 2

Cmimi dhe afati i pageses

2.1 Me ane te kesaj Kontrate, Shitesi detyrohet t'i japi dhe t'i kaloje Bleresit, Shoqerise "Doko" Shpk, 1 kuote nga Kuotat e Kapitalit Themeltar te Shoqerise Koncesionare "Bushtica 2017" Sh.p.k kundrejt vleres së caktuar ne piken 2.2 te kesaj Kontrate.

2.2 Bleresi duhet t'i paguaje Shitesve, kundrejt transferimit te pronesise se numrit perkates te Kuotave te Kapitalit Themeltar te Shoqerise Koncesionare "Bushtrica 2017" Sh.p.k, shumen prej 4900 leke.

2.3 Pagesa e cmimit te percaktuar ne piken 2.2 te ketij neni do te behet ne daten e nenshkrimt te kesaj kontrate.

Neni 3

Detyrimet e Paleve

3.1 Detyrimet e shoqerise "Erniku" Sh.p.k.

Shoqeria "Erniku" Sh.p.k. eshte e detyruar te:

- a) Te shese 1 kuote te kapitalit themeltar te "Bushtica 2017" Sh.p.k dhe te transferoje te gjitha te drejttat qe lidhen me te tek shoqeria "Doko" Sh.p.k.

3.2 Detyrimet e shoqerise "Doko" Sh.p.k.

Shoqeria "Doko" Sh.p.k. merr persiper dhe deklaron se:

- a) Do te paguaje, si bleres i 1 kuote te kapitalit themeltar te "Bushtica 2017" Sh.p.k, shumen totale prej 4900 (kater mije e nenteqind) leke sipas numrit te kuotave te blera paleve respektive, sipas percaktimeve te nenit 2.2 te kesaj kontrate.

3.3 Pavaresisht pageses se cmimit, palet bien dakort se menjehere pas nenshkrimt te kesaj kontrate, mund te behet regjistrimi i saj dhe dokumentave shoqeruese ne Qendren Kombetare te Biznesit per transferimin e kuotave dhe ndryshimin tek ortaket.

Neni 4 **Parashikime te pergjithshme**

4.1 Pavlefshmeria e nje apo me shume parashikimeve te kesaj kontrate nuk do te kete pasoja ose nuk do te cenoje vlefshmerine e parashikimeve te tjera te kesaj kontrate, e cila do te jete ne fuqi dhe do te prodhoje pasoja juridike, dhe palet mund te perdorin çdo parashikim pavaresisht pavlefshmerise se ketyre dispozitave.

4.2 Kjo kontrate ka forcën e ligjit për palët kontraktuese. Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve te tjera sipas parashikimeve te ligjit.

Neni 5 **Mosmarveshjet mes paleve**


5.1 Palet do te perpiqen qe te zgjidhin me mirekuptim cdo mosmarveshje ndermjet tyre.

5.2 Ne rast se mosmarveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 6 **Ligji i aplikueshem**

6.1 Kjo kontrate eshte hartuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

6.2 Per cdo paqartesi ose keqkuptim ne interpretimin dhe/ose zbatimin e kontrates palet do ti referohen dispozitave te legjislacionit shqiptar ne fuqi.



Neni 7
Dispozita te pergjithshme

7.1 Ndryshimet dhe/ose shtesat e kesaj kontrate do te jene te vlefshme dhe detyruese per palet vetem nese behen me shkrim dhe nenshkruhen nga palet.

7.2 Kjo kontrate hartohet ne 5 kopje ne gjuhen shqipe, nje kopje per secilen pale dhe nje kopje per zyren noteriale.

Kjo kontrate iu lexohet paleve me ze te larte e te qarte dhe pasi palet e gjejne kontraten ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, e nenshkruajne rregullisht kontraten para meje Noterit dhe une Noteri e vertetoj ate ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

SHITESI

"Erniku" Sh.p.k.
Iljaz Spahiu

Iljaz Spahiu *usej*

Dhenese e Pelqimit
Vera Spahiu
Vera Spahiu

Vera Spahiu

BLERESI

"Doko" Sh.p.k.
Fatbardh Doko

Fatbardh Doko
sh.p.k.

Pale e Trete
"Bushtrica 2017" Sh.p.k.
Anila Doko

Anila Doko
sh.p.k.

Notere

NOTERE
Maflinda E. Deyollari
NRPD: 20/09040A
Tel: 06 820/1500

